LIGJ
Nr.7554, datë 30.1.1992

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7498, DATË 5.7.1991 "PËR RUAJTJEN E RENDIT E TË QETËSISË"

Në mështetje të neneve 16 e 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7498, datë 5.7.1991 "Për ruajtjen e rendit e të qetësisë", neni 6 ndryshohet si vijon:

Ndalohet zënia dhe përdorimi arbitrarisht i apartamenteve të banimit apo i mjediseve të tjera shtetërore ose private pa lidhur në fillim kontratën përkatëse.

Në këto mjedise, me kërkesë me shkrim të personit juridik ose fizik të interesuar, organi i policisë urdhëron kundërvajtësin të lirojë menjëherë banesën ose mejdisin e zënë padrejtësisht. Në këto raste organet e policisë janë të detyruara të bëjnë lirimin e apartamentit të banimit apo mjediseve të tjera me forca të aktivizuara prej tyre.

Kur ka mosmarrëveshje për efekt pronësie ose qiraje, ky urdhër zbatohet pas miratimit nga organet e pushtetit lokal.

Shpenzimet që bëhen për këto veprime t'i ngarkohen kundërvajtësit sipas urdhrit të policisë, i cili është i formës së prerë.

Policia nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të vijnë nga veprimet që kryhen konform kërkesave të këtij ligji.

Përsëritja e veprimeve të tilla formon vepër penale e dënohet sipas Kodit Penal.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.124, datë 6.2.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.